



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KRYETARI

Nr. _____ Prot.

Maliq, më 24/04/2024

PROJEKT- VENDIM
Nr. 5, datë 24/04/2024

“Disa shtesa në Vendimin nr.136, datë 26.12.2023 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në bashkinë maliq,penalitetet dhe shkeljet apo kundravajtjet administrative për vitin 2024”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 dt 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 64 “Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë” pika c. si dhe neni 54 “Detyrat dhe Kompetencat e Këshillit Bashkiak”, pika f. ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurën tatimore në Republikën e Shqipërisë”, ligjit Nr. 9632 dt 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5 si dhe Vendimin nr. 136 datë 26.12.2023 të Këshillit të Bashkisë Maliq, “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë Maliq, penalitetet dhe shkeljet apo kundravajtjet administrative për vitin 2024”.i propozoj Këshillit të Bashkisë:

- I. Të miratojë disa shtesa në Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.136, datë 26.12.2023 si më poshtë:
 - I.1 Të miratojë tarifën në pikën 9.IV “ Tarifë për sistemin e ujitjes së tokës bujqësore” :
 - a) Ujitje nga stacioni i pompimit elektirk në Pojan – 2500 lekë/ora
 - I.2 Të miratojë tarifat pastrim, ndricim dhe gjelbërim për kategorinë e mëposhtme:
 - b)Ndërtim objekte të kombinuara :

Tarifë Pastrimi	– 25 000 lekë/ kantieri
Tarifë Gjelbërimi	– 3 000 lekë/ kantieri
Tarifë Ndiçimi	– 3 000 lekë/ kantieri
- II. Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të bëjë ndryshimet në buxhetin e bashkisë për vitin 2024
- III. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Korçë

KRYETARI I BASHKISË





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

DREJTORIA UJITJE –KULLUMI

Relacion për në Këshillin Bashkiak



Mbi argumentimin e tarifës së ujitjes së tokave bujqësore me ujin e marre nga St pompimi Pojan (me energji elektrike) .

Nga ana jonë si drejtori ujitje –kullim që kemi si detyrë kryesore menaxhimin e ujitjes dhe kullimit konkludojmë se st pompimi Pojan duhet të funksionojë normal me një tarifë që shprehet me lekë për orë pune .Kjo tarifë është menduar duke bërë përlllogaritjen konkrete të sasisë së ujit që ka kapaciteti i pompës për njësi të kohës , ku kapaciteti i saj është 280-300 litër ujë për sekondë .Teknikisht kjo sasi uji e nxjerrë nga st pompimit vendos në punë me kapacitet maksimal 15-20 litra ujë në sekondë 14-15 impjante.

Për arsye se linja e lëvizjes së ujit , pra rrjeti i kanaleve ujitës është i hapur dhe pa beton mundëson humbjen të cilat janë përlllogaritur duke ulur sasinë e ujit efektiv të shfrytëzueshëm nga 15 impiante në 10 impjante që do të thotë që fermeri do të shfrytëzojë 200 litra nga 280 që nxjerr stacioni ,pra me një diferencë 80 litra/ sek që konsiderohet humbje në rrjet .

Nga llogaritjet reale ju bëjmë me dije se çdo impjant i instaluar kap minimalisht 4 dy tokë dhe për të përfunduar ujitjen e plotë nevojiten 3 orë punë dhe kjo rezulton që për 10 impjante me nga 3 orë punë ujitjen gjithësej 40 dy tokë .Realisht në tarifën e miratuara për ujitje kemi që me ujitje me ngritje mekanike tarifa është 200 lek/dy dhe në rastin konkret me ujitjen me st pompimi elektrik për gjithë sasinë e tokës së ujitur në njësi të kohës të përcaktuar për ujitjen normale rezulton se 40 dy me çmimin aktual bëjnë $40 \times 200 = 8000$ lekë kjo e vlerësuar në orë të mjaftueshme = 3 na rezulton se me stacion pompimi elektrik që përfundon ujitja e 40 dy është menduar që të vihet një tarifë 2500 lek ora që për 3 orë = 7500 lek në ndryshim nga ajo me ngritje mekanike ka 500 lekë me pak në total nga ajo me ngritje mekanike .E thënë kjo në argumentimin e vlerave të kohës së harxhuar, kilovatëve të regjistruara dhe lekët e faturuara nga OSHE të mesatarizuara për vitin 2022 dhe vitin 2023 ,duke ju referuar 15 orë punë për vitin 2023 dhe vlerës së faturur 37431 lek na ka rezultuar që për një orë punë të dalin afërsisht 2500 lek për orë vlerë kjo e relatuar nga ana jonë për tu miratuar në këshill në mënyrë që të mundësojmë ujitjen dhe të shlyejmë detyrimin real pranë OSHE .Kjo tarifë presupozon vetëm vlerën e energjisë elektrike që harxhon stacioni dhe të gjitha kostot e tjera për mirmbajtje ,ruajtje dhe funksionim të stacionit nuk llogariten në këtë tarifë .

Për sqarime të mëtejshme të këtij relacioni ju mirpresim në mbledhjen e këshillit .

	(EmërMbiemër)	Nënshkrimi	Data
Konceptoi :	J .Thomo		Dt 24.04.2024
Relatoi :	A.Zholanji		Dt 24.04.2024

MIRATOI

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu

